



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M
nr. 416, datë 18.05.2016

“ Për
disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të
kontrollit teknik të automjeteve.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|-------------|
| • Znj. Lindita MILO (LATI) | Kryetare |
| • Znj. Servete GRUDA | Zv/Kryetare |
| • Z. Koço BROKA | Anëtar |
| • Znj. Iva ZAJMI | Anëtare |
| • Z. Eduard YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 18.05.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të monitorimit në tregun e kontrollit teknik të automjeteve.

Baza ligjore: Nenin 24, (germa f) dhe nenin 70, (pika 2) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në tregun e kontrollit teknik të automjeteve, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Tregu përkatës është shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve si një shërbim publik të detyrueshëm për përdoruesit e mjeteve motorike, i cili ofrohet në treg vetëm nga një ndërmarrje që gëzon të drejta të përcaktuar nga Marrëveshja “Për dhënien me konçesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” e nënshkruar në datë 03.09.2009, sipas Ligjit nr. 9663, dt 18.12.2006 “Për konçesionet”- (i ndryshuar) dhe kuadrit nënligjor të tij, mes Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (këtu e vijim-MTI), ish-Ministria Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit nga njëra anë dhe nga ana tjetër prej konçesionarit SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A, kompani e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjenevës.

2. Në përputhje më marrëveshjen konçesionare, tregu i shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve është treg i modelit të centralizuar (i ndarë nga shërbimi i servisit), me një ndërmarrje të vetme të ofrimit të shërbimit dhe struktura monopoliste e tregut sipas marrëveshjes konçesionare parashikohet se do të vazhdojë deri në vitin 2019 dhe marrëveshja parashikon mundësinë e ridiskutimit për periudhën në vazhdim.
3. Si detyrim i përcaktuar në pikën 2.1.5 të Marrëveshjes së Konçesionit¹: *shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve ofrohet nëpërmjet ndërmarrjes SGS Automotive Albania shpk, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (këtu e vijim-QKR) në datë 10.09.2009, ku ortak i vetëm i saj është SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A.*
4. Në mbështetje të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), në nenin 2, pika 1 germa a), i cili parashikon zbatimin e Ligjit “Për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”, si dhe në kuadër të detyrave funksionale të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës, u realizua monitorimi i tregut të kontrollit teknik të automjeteve.
5. Në përputhje me fazën në të cilën ndodhet ekzekutimi i të drejtës ekskluzive të konçesionit sipas parashikimeve të nenit 2, pika c, nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës është fokusuar në sjelljen ndaj tarifave për shërbimin e detyrueshëm të kontrollit teknik të automjeteve, të cilat miratohen nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe nëse ka justifikim ekonomik të rritjes së këtyre tarifave kundrejt performancës së ndërmarrjes konçesionare sa i përket rritjes së cilësisë së shërbimit, shmangien e radhëve dhe lëshimin e garancive teknike për kontrollin e automjeteve.
6. Nga analiza e treguesve të performancës u konstatua se *konçesionari* ka realizuar investime në krijimin e mjediseve të përshtatshme për punë, investime në pajisje dhe software në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Transportit si dhe direktivat e BE, ka sjellë eksperiencën më të mirë të ndërmarrjes “*mëmë*” më specialistë dhe pajisje, ka realizuar aplikimin “on-line” të rezervimit të datës së kontrollit teknik, në website zyrtar ka informacion të plotë mbi procedurat, dokumentacionin, adresat, kontaktet për një shërbim të shpejtë si dhe ka venë në dispozicion të klientëve një numër kontakti (e afishuar edhe në ambjentet ku kryhet kontrolli teknik) për çdo sjellje abuzive nga ana e punonjësve të ndërmarrjes konçesionare.
7. Sipas kontratës së konçesionare, lidhur me Ministrinë e Transportit, nenet 8.2.1 dhe 8.2.2 : *“ndryshimi i tarifave së kontrollit rishikohet nga konçesionari çdo tre vjet dhe miratohet nga Ministria e Transportit sipas formulës: $IR = (NI2 - NI1) / NI1$ ku NI1*

¹ “Konçesionari brenda 2 (dy) javëve nga data efektive e kësaj kontrate do themelojë një shoqëri tregtare në vazhdim “shoqëri konçesionare”, të cilës do të transferohen të gjitha të drejtat dhe Detyrimet e Konçesionarit sipas kësaj kontrate”.

paraqet normën e inflacionit në vitin e trete pararendës dhe NI2 paraqet normën e inflacionit të vitit në të cilin do të kryhet rishikimi i tarifës”.

8. Sipas informacionit që disponojmë rishikimi i tarifave është realizuar në 6 shtator 2010, kur kanë ndryshuar tarifat që aplikoheshin para konçesionit dhe në 6 shtator 2013, me një rritje mesatare 9.38%. Nga ndërmarrja “SGS Automotive sh.p.k.” nuk janë paraqitur arsyet dhe analiza ekonomike e rritjes së tarifave edhe pse u kërkua nga Autoriteti i Konkurrencës. Ndryshimi i pritshëm i tarifave i përket shtatorit të vitit 2016, për të cilën Autoriteti i Konkurrencës do të kërkojë bashkëpunimin e ngushtë të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës përpara miratimit të tarifave të propozuara nga ndërmarrja koncensionare.
9. Nga përpunimi i informacionit të grumbulluar nëpërmjet pyetësorëve drejtuar përfituesve të shërbimit, është konstatuar se:
 - a- Automjetet më problematike për përmbushjen e kriterëve të kolaudimit teknik janë automjetet me lëndë djegëse me benzinë, por pa gjetur elemente detyrues nga koncesionari, për të vendosur pajisje shtesë në automjet, për zvogëlimin e emetimit të gazrave;
 - b- Mungon ndërgjegjësimi i klientëve për aplikimin e rezervimit paraprak të orës së marrjes së shërbimit, duke sjellë vonesa dhe radhë në realizimin e procedurës së kontrollit;
 - c- Plotësimi i një deklaratë-tip, të hartuar nga koncesionari, e vendos përfituesin e shërbimit në kushte të pafavorshme, në rastin e shkaktimit të dëmit gjatë procedurës së kontrollit teknik;
 - d- Ekziston ende edhe dukuria e pagesave shtesë, informale, për të kaluar provën e kontrollit teknik.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja f dhe neni 70, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

V E N D O S I:

1. T’u rekomandojë palëve kontraktore të koncensionit, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe ndërmarrjes koncensionare SGS Automotive Albania sh.p.k, që:

- 1.1 Para ndryshimit të tarifave të shërbimit që pritet të ndodhin në muajin shtator 2016, palët duhet të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës, informacionet përkatëse mbi analizën ekonomike për vendosjen e këtyre tarifave të reja.
- 1.2. Koncesionari duhet të rishikojë dhe ndryshojë përmbajtjen e paragrafit të tretë, të Deklaratës-Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, duke përcaktuar në të shkaktarin e dëmit si dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.

2. Ministria e Transportit dhe e Infrastruktures duhet te marre masa per hapjen e ketij tregu per konkurrence, sipas praktikave dhe standarteve me te mira nderkombetare pas perfundimit te periudhes konçesionare.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe njoftimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si dhe koncesionarit SGS Automotive Albania shpk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Zv/Kryetar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R